



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok.202100793/5

Tiranë ____/____/2021

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave ligjore për shpejtimin e gjykimit të çështjes administrative nr.31114-00905-86-2018, datë regjistrimi 01.03.2018 me palë paditëse L.P dhe P.P.*

GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT
Tiranë

Të nderuar,

Sikurse jeni në dijeni në institucionin e Avokatit të Popullit është paraqitur ankesë nga shtetasja J.P, ku parashtron se ka të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit çështjen nr.31114-00905-86-2018, data e regjistrimit 01.03.2018, me të dhënat e mëposhtme:

Paditës: L.P, P.P
I paditur: ZVRPP Sarandë, Bashkia Himarë
Palë të treta: P.Z

Objekti i padisë: Pavlefshmëri të listës së trojeve të fshatit Borsh përsa i përket pasurisë me nr.41/15, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtim 95 m² në emër të P.Z dhe si pasojë

pavlefshmëri të regjistrimit të kësaj prone. Shuarjen nga lista e trojeve të fshatit Borsh të pasurisë me nr.41/15, vol 2, faqe 8 me sipërfaqe trualli 300 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 95m² në emër të P.Z. Detyrimin e ZVRPP Sarandë të bëjë kalimin nga hipoteka në sistem të apartamentit të banimit dykatësh me sipërfaqe ndërtimi dhe trualli 109,2 m² i ndodhur në fshatin Borsh, në Zonën Kadastrale nr.1253 i regjistruar fillimisht në librin hipotekor të apartamenteve me nr.16, faqe 5 dhe regjistrimin në sistem të këtij aparatamenti në emër të bashkëpronarëve L.P, V.P, A.P dhe P.P dhe mbi këtë bazë pajisjen me certifikatë pronësie.

Sipas ankueses, ka kaluar një periudhë kohore mbi tre vjet e gjysëm që kjo çështje është regjistruar në këtë gjykatë dhe deri më tani, nuk ka asnjë zhvillim lidhur me mundësinë e gjykimit të saj.

Për adresimin e këtij shqetësimi të përcjellë nga shtetasja dhe për të marrë një informacion shterues, bazuar në nenin 63 pika 4 të Kushtetutës, si edhe në nenin 19/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i jemi drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit. Bazuar në korrespondencën që kemi pasur me këtë gjykatë, me shkresën nr.15/1 prot., datë 30.07.2021 ky organ është shprehur se pala nuk i është drejtuar gjykatës me kërkesë për përshpejtim gjykimi, kërkesë e cila të merret në shqyrtim nga ana e gjyqtarit relator.

Në vlerësim të Avokatit të Popullit e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor është një ndër të drejtat themelore të qytetarëve shqiptarë. Për këtë arsye, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është standard kushtetues, i garantuar dhe sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtar (neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), ashtu edhe në të drejtën e brendshme (neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹).

¹ Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se:

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

Neni 6 i KEDNJ-së² zë një vend të rëndësishëm në tërësinë e të drejtave që garanton kjo konventë. Një gjykim i drejtë në çështje civile dhe penale është një element bazë i parimit të shtetit të së drejtës. Midis garancive që lidhen direkt ose indirekt me gjykatën janë ndër të tjera: publiciteti i gjykimit (seancat e hapura dhe shpallja e vendimit publikisht), mënyra e zhvillimit të rregullt të seancave gjyqësore, konkretisht elementë të tillë si: barazia e armëve, afati i arsyeshëm, arsyetimi i vendimeve etj.

Në Kodin e Procedurës Civile të RSH, ashtu si disa legjislacione evropiane, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga GJEDNJ, janë parashikuar edhe mjete të veçanta ankimi, me qëllim përshpejtimin e proceseve gjyqësore. Një nga këto mjete është edhe padia e veçantë e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës Civile lidhur me zgjatjen e procesit tej afatit të arsyeshëm. Me anë të këtij ankimi pala e interesuar ka mundësinë për të ndikuar drejtpërdrejt në një përshpejtim të procesit. Me anë të kësaj padie, qytetari jo vetëm konstaton tejzgjatjen pa arsye të procesit, por mund të marrë dhe dëmshpërblim (nëse e kërkon) për vonesën e shkaktuar. Vendimi në këtë rast urdhëron gjykatën kompetente ta shqyrtojë çështjen sa më parë. Natyrisht, në disa

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

² Sipas nenit 6 “E drejta për një proces të rregullt” të KEDNJ-së:

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b) t’i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

raste te jzgjatja e procesit gjyqsor ka shkaqe objektive. Nj nj rast t till kjo padi mund t bhet shkak pr evidencimin e arsyeve konkrete dhe ndoshta edhe pr eliminimin e tyre nga organet kompetente. Pra, ky mjet duhet konsideruar me efekt parandalues, nj rast t te jzgjatjes pa shkak t procesit, pra q cdo individ ka nj mjet efikas q do t'i vij n ndihm.

Sjellim nj vemdje q nj muajin tetor 2021, GJEDNJ ka vendosur pr rastin e dy kerkuesve, Bara and Kola v. Albania, shtetas shqiptar q jan ankuar pran ktij institucioni pr kohzgjatjen e procedurave gjyqsore nj Shqipri. Kjo Gjykat t ka vendosur se nj keto raste *esht shkelur e drejta pr gjykim brenda nj afati t arsyeshm*.³

Duke mos shprfillur vonesn e kuptueshme q rrjedh nga reformat e thella t sistemit t drejtësisë dhe procesi i vettingut, Gjykata ripohoi se shtetet kishin nj detyrim t pergjithshëm pr t organizuar sistemet e tyre ligjore nj mnyr q t siguronin prrputhjen me kerkesat e nenit 6 paragrafi 1 t Konventës, duke prfshir at t nj gjykimi t drejt brenda nj afati t arsyeshm.

S fundmi, ndonse nuk i takonte Gjykatës t vendoste pr interpretimin e duhur t ligjit t brendshëm, ajo konsideroi se qasja e Gjykatës s Lart nj çshtjen e aplikantit t par pr t moslogaritur efektet e reformave t vazhdueshme t sektorit t drejtësisë nj funksionimin e tij nj shtrirjen e pergjithshme t procedurave, nj keto rrethana, nuk do t ishin nj prrputhje me jurisprudencn e saj sipas nenit 6 paragrafi 1 mbi kerkesn e "*afatit s arsyeshm*", pasi mund t zhvendoste tek pal t ndërgjyqse individuale barrn e plot t cdo vonese t shkaktuar nga reformat nj sektorin e drejtësisë.

Prrveç ksaj, u konstatua se mjeti i ri juridik sipas Kodit t Procedurës Civile, i miratuar nj vitin 2017, nuk kishte ndihmuar nj prshpejtimin e gjykimeve, duke mos i len ankuesit t par asnj mjet juridik nj dispozicion pr t'u marr me shkeljen e t drejtave

³ Bara and Kola v. Albania - [43391/18](#) and [17766/19](#)
Judgment 12.10.2021

të tij sipas nenit 6 paragrafi 1. Megjithatë, Gjykata deklaroi se mjete i ri juridik është në parim i pajtueshëm me nenin 13 dhe për këtë arsye duhet të shterret përpara se të paraqiten ankesa të ngjashme në Gjykatë.

Në nenin 48, pika 2 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe Gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, parashikohet se *“Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi.”*

Gjithashtu, në ligjin nr.49/2012, konkretisht në nenin 3 të tij, renditet si një ndër parimet themelore të gjyimit administrativ edhe sigurimi i një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme, kjo me synimin për të garantuar një mbrojtje efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave.

Nga ana tjetër, vetë Kodi i Procedurës Civile, i cili përcakton rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera, me ndryshimet e vitit 2017, i ka kushtuar vëmendje të veçantë çështjes së respektimit të afatit të arsyeshëm të gjyimit, duke e trajtuar këtë institut në një kre të veçantë. Në dispozitën e nenit 399/2, pika 1 të këtij ligji përcaktohet se:

“1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjyimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

a) në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjyimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë;

b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjyimit brenda dy viteve, në gjykim civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve;.....”

Në vendimin nr.78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit” përcaktohet se:

“Caktimi i datës dhe orës së gjykimit të çështjes së ardhur mbi ankim të palës/palëve, bëhet nga gjyqtari relator, në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën sipas kohës së ardhjes së dosjeve në Gjykatën e Apelit.”

Dispozitat e lartpërmendura të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr.49/2012, kanë si qëllim vendosjen për herë të parë të standardeve, si dhe një kufi në raport me termat kohorë lidhur me gjykimin brenda afatit të arsyeshëm. Kështu, në çdo rast, sipas dispozitës së nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile, gjykimi administrativ në shkallën e parë dhe në apel nuk mund të zgjasë më tepër se një vit nga fillimi i tij në secilën shkallë.

E drejta e gjykimit brenda një afati të shpejtë dhe të arsyeshëm është jo vetëm një garanci për mbrojtjen e palëve nga zvarritjet e paarsyeshme të procedurave, por mbi të gjitha garanton se brenda një afati të arsyeshëm pala kërkuese do të përfitojë eventualisht nga të drejtat që i janë mohuar, duke i mundësuar asaj siguri juridike në raport me pozitën procedurale. Për më tepër, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, përveçse është një standard të cilin organi gjyqësor ka detyrimin ta respektojë *apriori*, është mbi të gjitha një standard që vlerësohet në mënyrë të veçantë për secilin rast konkret, nisur nga specifika, kompleksiteti, tërësia e të drejtave të shkelura apo të pretenduara, etj.

Mosgjykimi i çështjes gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, jo vetëm cenon të drejtën e ankuesit për një proces të rregullt ligjor, por për më tepër, zvarrit eventualisht përfitimet, pasi nuk e lejon të ketë as send apo pjesë të tij dhe as fryte civile që i takojnë me ligj.

Dëshirojmë të theksojmë se institucioni i Avokatit të Popullit është në dijeni të faktit se në Gjykatën Administrative të Apelit ka një numër të konsiderueshëm të çështjeve administrative të paraqitura për gjykim, gjë që çon në ngarkesë voluminoze të punës së gjyqtarëve, shoqëruar kjo edhe me vakancat e shkaktuara si rrjedhojë e procesit të vettingut.

Gjithashtu, jemi të vetëdijshëm se kjo çështje nuk hyn në çështjet me natyrë dhe kategori specifike që duhet të gjykohen me prioritet sipas vendimit nr.78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”.

Pandemia Covid-19 ka krijuar sfida të jashtëzakonshme për të gjithë autoritetet shtetërore dhe gjyqësore. Sistemi gjyqësor sikurse të gjithë institucionet publike në vendin tonë u përball me vështirësi të reja, krahas atyre me të cilat është hasur ky sistem vitet e fundit për arsye të procesit të vettingut. Sigurisht, pezullimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, me përjashtim të çështjeve me natyrë të ngutshme, për një periudhë të gjatë 3 muajore solli si pasojë zvarritje të proceseve gjyqësore, shtyrje të gjykimit të çështjeve të reja, si dhe problematika në respektimin e plotë të të drejtave procedurale gjatë gjykimit.

Pavarësisht kësaj gjendjeje, çmujmë se gjykimi i çështjeve në kohë nevojitet të adresohet. Duke qenë se afati i mësipërm në rastin konkret është tejkaluar, pasi çështja është regjistruar në muajin mars të vitit 2018 dhe ndërkohë ende nuk është bërë shqyrtimi i dosjes, është cenuar kështu e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuarin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit⁴. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se për të arritur në konkluzionin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet të vlerësohet analiza e secilit prej elementeve të sipërcituara.

⁴ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.69 datë 17.11.2015.

Për gjithë sa parashtruam, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*:

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave ligjore për shpejtimin e gjykimit të çështjes administrative nr.31114-00905-86-2018, data e regjistrimit 01.03.2018 me paditës: L.P, P.P, të paditur: ZVRPP Sarandë, Bashkia Himarë, palë të treta: P.Z.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi